



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 17, paragrafi 1, shkronja (b) dhe (c), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008” neneve 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, miraton këtë:

### **Projekt-V E N D I M**

**Për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-20154, të datës 30.03.2021**

#### **Neni 1**

Me këtë vendim ndryshohet-plotësohet vendimit, 01-Nr-016-20154 i datës 30.03.2021, për caktimin e lokacionit për vendosjen e trafostacioneve dhe dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, me qëllim të ndryshimit të lokacionit sipas kërkesës së KEDS-it.

#### **Neni 2**

**Pika 1.5, e Nenit 1, të vendimit bazik me numër të protokollit 01-Nr-016-20154, të datës 30.03.2021, ndryshohet dhe riformulohet si vijon:**

Në fshatin Budakovë në parcelën kadastrale **P-72116004-02936-0**, me sipërfaqe të përgjithshme prej; **32749m<sup>2</sup>**, sipas certifikatës së pronës **nr. 2536/2022**, datës 08.07.2022, zona kadastrale **Budakovë**, vendi i quajtur **“Rrahi Metes Guri Madh”**, e evidentuar pasuri shoqërore rrugët në emër Komuna e Suharekës, nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen **9m<sup>2</sup>** për vendosjen e trafostaconit të energjisë elektrike.

#### **Neni 3**

Ndërsa pjesët tjera kompletë të vendimit bazë me numër 01-Nr-016-20154 i datës 30.03.2021, mbesin të pa ndryshuara.

#### **Neni 4**

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

### **KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË**

01-Nr-\_\_\_\_\_  
Më datë\_\_\_\_\_

Kryesuesi i Kuvendit  
\_\_\_\_\_  
**Mr.ec Bexhet KUÇI**